

Ligj për universitetet e hapura qytetare për mësim të përjetshëm

Ligj për universitetet e hapura qytetare për mësim të përjetshëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 36/2011 dhe 41/2014).

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen veprimtaria, administrimi, udhëheqja, financimi, mbikëqyrja, si dhe çështje tjera lidhur me punën e universiteteve të hapura qytetare për mësim të përherëshëm.

Neni 2

Nocione të veçanta të përdorura në këtë ligj e kanë kuptimin në vijim:

1. "Universitete të hapura qytetare për mësim të përherëshëm" janë institucionet që kryejnë shërbim publik si veprimtari nga sfera e arsimit formal të të rinjve dhe personave të rritur (arsim fillor për të rritur, arsim të mesëm për të rritur, aftësim profesional, arsim profesional për profesion, arsim teknik dhe arsim pas arsimit të mesëm për të rritur, rikualifikim dhe kualifikim plotësues) në pajtim me Ligjin për arsimin e të rriturve, si dhe arsim joformal të të rinjve dhe personave të rritur, të dedikuar për aftësim për punë, për aktivitete të ndryshme sociale ose zhvillim personal në pajtim me Ligjin për arsimin e të rriturve.
2. "Nxënës" është personi që i shfrytëzon shërbimet e universiteteve të hapura qytetare për mësim të përherëshëm nga sfera e arsimit formal të të rinjve dhe personave të rritur, në pajtim me Ligjin për arsimin e të rriturve.
3. "Pjesëmarrës" është personi që i shfrytëzon shërbimet e universiteteve të hapura qytetare për mësim të përherëshëm nga sfera e arsimit joformal të të rinjve dhe personave të rritur, në pajtim me Ligjin për arsimin e të rriturve.

Neni 3

(1) Në universitetet e hapura qytetare për mësim të përherëshëm realizohet arsimi formal dhe joformal i të rinjve dhe personave të rritur.

1. Arsimi formal i të rinjve dhe personave të rritur i përfshin:

- arsimin fillor për të rritur,
- arsimin e mesëm për të rritur, aftësimin profesional, arsimin profesional për profesion, arsimin teknik dhe arsimin pas arsimit të mesëm për të rritur, si dhe rikualifikimin dhe kualifikimin plotësues.

Arsimi fillor për të rritur realizohet në universitetet e hapura qytetare për mësim të përherëshëm, si arsim i rregullt dhe me korrespondencë.

Arsimi i mesëm për të rritur, aftësimi profesional, arsimi profesional për profesion, arsimi teknik dhe arsimi pas arsimit të mesëm për të rritur, si dhe rikualifikimi dhe kualifikimi plotësues realizohen në universitetet e hapura qytetare për mësim të përhershëm, edhe atë si arsim i rregullt dhe me korrespondencë.

Arsimi formal për të rritur realizohet në pajtim me ligjet që e rregullojnë këtë veprimtari, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

2. Arsimi joformal i të rinjve dhe personave të rritur paraqet procese të organizuara të mësimit, të dedikuara për aftësim të të rinjve dhe personave të rritur për punë, për aktivitete të ndryshme sociale ose zhvillim personal në pajtim me Ligjin për arsimin e të rriturve.

(2) Universitetet e hapura qytetare për mësim të përhershëm janë institucione publike, të përziera ose private që kryejnë veprimtari me interes publik.

(3) Universitetet e hapura qytetare për mësim të përhershëm kanë cilësi të personave juridikë.

Neni 4

(1) Universiteti i hapur qytetar për mësim të përhershëm ka statut.

(2) Me statutin kryesisht rregullohen: organizimi dhe kryerja e veprimtarisë, emri, selia, administrimi dhe udhëheqja, kontrolli, të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësve, të drejtat dhe detyrimet e të punësuarve dhe çështje tjera me rëndësi për punën e universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm.

(3) Statutin e universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm, e miraton Këshilli Drejtues.

(4) Për statutin e universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm, pëlqim jep Ministria e Arsimit dhe Shkencës (në tekstin e mëtejme: Ministria), pas mendimit pozitiv paraprak nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit, Qendra për Arsim dhe Trajnim Profesional dhe Qendra për Arsimin e të Rriturve.

II. DOKUMENTACIONI DHE EVIDENCA PEDAGOGJIKE

Neni 5

Universiteti i hapur qytetar për mësim të përhershëm dokumentacionin dhe evidencën pedagogjike e mban dhe e lëshon në pajtim me këtë ligj, Ligjin për arsim fillor, Ligjin për Byronë për Zhvillimin e Arsimit, Ligjin për arsim profesional dhe trajnim dhe Ligjin për arsim të të rriturve.

III. ADMINISTRIMI DHE UDHËHEQJA ME UNIVERSITETET E HAPURA QYTETARE PËR MËSIM TË PËRHERSHËM

1. Organi i administrimit

Neni 6

(1) Organ i administrimit të universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm është Këshilli Drejtues.

(2) Këshillin Drejtues e përbëjnë pesë anëtarë: dy anëtarë nga radhët e të punësuarve në universitetin e hapur qytetar për mësim të përhershëm, dy persona që i emëron themeluesi i universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm dhe një anëtar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

(3) Kryetari i Këshillit Drejtues emërohet nga radhët e anëtarëve të Këshillit Drejtues.

(4) Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Drejtues emërohen me mandat prej pesë vitesh dhe mund të riemërohen vetëm edhe një herë.

(5) Vendimet e Këshillit Drejtues miratohen me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

Neni 7

(1) Të punësuarit në universitetin e hapur qytetar për mësim të përhershëm përfaqësuesit e vet në Këshillin Drejtues i zgjedhin në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë.

(2) Mënyra e zgjedhjes së përfaqësuesve të të punësuarve në universitetin e hapur qytetar për mësim të përhershëm në Këshillin Drejtues, përcaktohet me statutin e universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm.

Neni 8

Kryetar i Këshillit Drejtues mund të emërohet personi që i plotëson kushtet në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- ta ketë të kryer arsimin e lartë dhe
- të ketë përvojë pune prej tre vitesh.

Neni 9

Këshilli Drejtues i universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm:

- e miraton statutin e universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm,
- e zbaton procedurën për emërimin dhe shkarkimin e drejtorit,
- e miraton programin vjetor për punën e universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm dhe ia dorëzon për miratim themeluesit, më së voni deri më 1 nëntor,

- e miraton raportin vjetor për punën e universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm dhe ia dorëzon themeluesit, më së voni deri më 1 mars,
- e miraton llogarinë përfundimtare,
- e miraton raportin financiar vjetor për universitetin e hapur qytetar për mësim të përhershëm, më së voni deri më 1 mars,
- jep pëlqim për aktet për organizim dhe punë dhe sistematizim të vendeve të punës në universitetin e hapur qytetar për mësim të përhershëm,
- vendos për kundërshtimet dhe ankesat lidhur me marrëdhënien e punës të të punësuarve në universitetin e hapur qytetar për mësim të përhershëm,
- miraton rregulloret për punën e vet, dhe
- kryen punë tjera të përcaktuara me ligjin dhe statutin.

2. Organi i udhëheqjes

Neni 10

(1) Me universitetin e hapur qytetar për mësim të përhershëm udhëheq drejtori.

2

(2) Drejtor mund të emërohet personi që i plotëson kushtet në vijim:

- 1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- 2) në momentin e emërimit me aktvendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim aposanksion i kundërvajtjes ndalim për kryerje të profesionit, veprimtarisë apo detyrës;
- 3) ka fituar së paku 240 kredi sipas SETK apo ka mbaruar shkallë VII/1;
- 4) ka të dhënë provimin për drejtor për shkollë fillore, përkatësisht shkollë të mesme;
- 5) ka minimum pesë vjet përvojë pune;
- 6) posedon njërën nga certifikatat ose dëshmitë vijuese të njohura ndërkombëtarisht për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet: 3
 - TOEFEL IBT së paku 74 pikë,
 - IELTS (IELTS) - së paku 6 pikë,
 - ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) - së paku niveli B2 (B2),
 - FCE (FCE) (Cambridge English: First) - të dhënë,
 - BULATS (BULATS) - së paku 60 pikë apo
 - APTIS (APTIS) - së paku niveli B2 (B2) dhe
- 7) ka të dhënë testin psikologjik dhe testin për integritet.

(3) Me përjashtim, nëse nuk është paraqitur kandidat me provim të dhënë për drejtor, drejtor mund të zgjidhet edhe personi i cili nuk e ka dhënë provimin për drejtor, mirëpo detyrohet që atë ta japë në afat prej një viti nga dita e zgjedhjes si drejtor.

(4) Nëse drejtori i zgjedhur nuk e jep provimin për drejtor në afatin e përcaktuar në paragrafin (3) të këtij neni, i pushon mandati i drejtorit. (5) Drejtori emërohet për kohë prej katër vjetësh dhe mund të riemërohet edhe për një mandat.

Neni 11

Drejtori i universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm i kryen punët në vijim:

- e organizon dhe udhëheq punën e universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm,
- e prezanton dhe e përfaqëson universitetin e hapur qytetar për mësim të përhershëm,
- e propozon programin vjetor për punën e universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm në Këshillin Drejtues, më së voni deri më 1 tetor,
- e propozon raportin vjetor për punën e universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm në Këshillin Drejtues, më së voni deri më 31 janar,
- e propozon në Këshillin Drejtues llogarinë përfundimtare,
- e propozon raportin financiar vjetor të universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm në Këshillin Drejtues, më së voni deri më 1 shkurt,
- e organizon realizimin e programit vjetor,
- i miraton aktet për organizim dhe punë dhe sistematizim të vendeve të punës në universitetin e hapur qytetar për mësim të përhershëm,
- i miraton aktet lidhur me marrëdhënien e punës me të punësuarit,
- përgjigjet për punën financiare-materiale dhe ligjshmërinë e punës së universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm dhe
- kryen punë tjera të përcaktuara me ligj dhe statut.

Neni 12

(1) Drejtorin e universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm e emëron dhe shkarkon Këshilli Drejtues i universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm.

(2) Këshilli Drejtues i universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm tre muaj para kalimit të mandatit të drejtorit ekzistues miraton vendim që të shpall konkurs publik në së paku tri gazeta ditore të cilat botohen në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë, nga të cilat njëra nga gazetatat që botohen në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase për emërim të drejtorit. [4](#)

(3) Në konkursin publik në mjetet e informimit publik përcaktohen kushtet të cilat duhet t'i plotësojë kandidati për drejtor, dokumentacioni i nevojshëm, kohëzgjatja e konkursit publik dhe afati në të cilin do të kryhet emërimi.

(4) Kandidatët e paraqitur i dërgojnë dokumentet e nevojshme në Këshillin Drejtues të universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm. Kandidatët fletëparaqitjes duhet t'i bashkëngjisin program për punën e universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm për periudhë prej katër vjetësh.

(5) Dokumentet e arritura i shqyrton komisioni i përbërë prej tre anëtarësh, i zgjedhur nga Këshilli Drejtues kompetenca e të cilit përcaktohet me statutin e universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm.

(6) Komisioni nga paragrafi (5) i këtij neni në afat prej shtatë ditësh pas mbarimit të konkursit publik i shqyrton dokumentet e arritura dhe Këshilli Drejtues i dorëzon listë të kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet për drejtor të universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm.

(7) Nga lista e kandidatëve nga paragrafi (6) i këtij neni, Këshilli Drejtues me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së listës emëron drejtor të universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm.

(8) Nëse Këshilli Drejtues, në afatin e përcaktuar në paragrafin (7) të këtij neni, nuk emëron drejtor, emërimin e kryen ministri kompetent i arsimit (në tekstin e mëtejshëm: ministri).

(9) Kandidatët të cilët nuk emërohen, në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimin të vendimit, kanë të drejtë ankese lidhur me zbatimin e procedurës për zgjedhje të drejtorit në Komisionin e shkallës së dytë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, kompetent për zgjidhjen e çështjeve nga sfera e marrëdhënieve të punës.

(10) Kundër vendimit të komisionit nga paragrafi (9) i këtij neni, kandidati mund të ngritë kontest administrativ para gjykatës kompetente.

Neni 13

(1) Nëse nga çfarëdo shkak nuk emërohet drejtor i universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm, Këshilli Drejtues pa konkurs publik do të emërojë ushtrues detyre drejtor nga radhët e të punësuarve në universitetin e hapur qytetar për mësim të përhershëm.

(2) Ushtruesi i detyrës drejtor i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e drejtorit të universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm.

(3) Ushtruesi i detyrës drejtor emërohet për kohë deri në zgjedhjen e drejtorit, e më së gjati për gjashtë muaj.

(4) Ushtrues detyre drejtor mund të emërohet personi që i plotëson kushtet si për zgjedhje të drejtorit.

Neni 14

(1) Drejtorit të universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm i pushon mandati, nëse:

- atë e kërkon vetë,
- përgjithmonë e humb aftësinë për kryerjen e detyrës drejtor dhe
- i plotëson kushtet për pension sipas pleqërisë.

(2) Drejtori i universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm shkarkohet para kalimit të mandatit, nëse:

- kryen shkelje të dispozitave të ligjeve ose rregullave dhe akteve tjera, të përcaktuara nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit,
- nuk e realizon programin për punë,

- me fajin e tij u shkakton dëm pjesëmarrësve dhe nxënësve ose universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm,
- lejon organizmin e veprimtarive dhe aktiviteteve që janë në kundërshtim me planin mësimor dhe programet, dhe
- lejon pagesën e mjeteve të cilat nuk janë përcaktuara në planin financiar vjetor të universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm.

(3) Iniciativë për shkarkimin e drejtorit para kalimit të mandatit në Këshillin Drejtues mund të parashtrojë themeluesi dhe Inspektorati Shtetëror i Arsimit, nëse konstatohet parregullsi nga paragrafi (2) i këtij neni.

3. Organi profesional

Neni 15

(1) Organ profesional i universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm është këshilli i arsimtarëve.

(2) Këshillin e arsimtarëve të universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm e përbëjnë arsimtarët dhe bashkëpunëtorët profesionalë. Këshillin e arsimtarëve e konvokon dhe me të kryeson drejtori.

(3) Këshilli i arsimtarëve i universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm:

- jep mendim për programin vjetor për punë dhe e ndjek zbatimin e tij,
- e shqyrton dhe përcakton suksesin e pjesëmarrësve dhe nxënësve,
- e shqyrton realizimin e programit dhe ndërmer masa për zbatimin e tij,
- miraton vendime për kundërshtimet e pjesëmarrësve dhe nxënësve për notat e përcaktuara,
- e shqyrton raportin nga realizimi i programit vjetor për punë dhe propozon masa përkatëse,
- debaton dhe vendos për çështje profesionale lidhur me punën edukative-arsimore.
- jep mendim për planin financiar vjetor të universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm,
- jep mendim për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e arritjeve në procesin mësimor dhe në mësim dhe
- kryen edhe punë tjera të përcaktuara në statutin e universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm.

IV. FINANCIMI I PUNËS SË UNIVERSITETEVE TË HAPURA QYTETARE PËR MËSIM TË PËRHERSHËM

Neni 16

Mjetet për financimin e universiteteve të hapura qytetare për mësim të përhershëm mund të sigurohen nga të hyrat e veta nga shërbimet e kryera, nga themeluesi, nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, si dhe nga legjet, dhuratat, donacionet dhe nga burimet tjera.

V. MBIKËQYRJA

Neni 17

- (1) Mbikëqyrje mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji, kryen Ministria.
- (2) Mbikëqyrje inspektuese mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji, kryen Inspektorati Shtetëror i Arsimit, në pajtim me ligjin.
- (3) Inspektorati Shtetëror i Arsimit, në pajtim me ligjin, kryen evaluim integral të universiteteve të hapura qytetare për mësim të përhershëm.

Neni 18

- (1) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori shtetëror i arsimit konstaton se është kryer parregullsi nga neni 19 paragrafët (1) dhe (2), detyrohet që të përpilojë procesverbal në të cilin do ta përcaktojë parregullsinë e kryer me sugjerim për mënjanimin e parregullsisë së konstatuar në afat prej tetë ditësh dhe me dorëzim të njëkohshëm të ftesës për realizimin e edukimit të personit ose universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm, ku është konstatuar parregullsia gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.
- (2) Formën dhe përmbajtjen e ftesës për edukim, si dhe mënyrën e realizimit të edukimit e përcakton ministri.
- (3) Edukimin e organizon dhe e realizon Inspektorati Shtetëror i Arsimit i cili e ka kryer mbikëqyrjen inspektuese, në afat jo më të gjatë se tetë ditë nga dita e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.
- (4) Edukimi mund të realizohet për më tepër parregullsi të konstatuara të njëjta ose të ngjashme për një ose më tepër persona, përkatësisht një ose më tepër universitete të hapura qytetare për mësim të përhershëm.
- (5) Nëse në terminin e caktuar personi ose universiteti i hapur qytetar për mësim të përhershëm për të cilin realizohet edukimi nuk paraqitet në edukim, do të konsiderohet se edukimi është realizuar.
- (6) Nëse personi ose universiteti i hapur qytetar për mësim të përhershëm për të cilin realizohet edukimi paraqitet në edukimin e caktuar dhe e kryen atë, do të konsiderohet se është edukuar lidhur me parregullsinë e konstatuar.
- (7) Nëse inspektori shtetëror i arsimit gjatë kryerjes së mbikëqyrjes kontrolluese konstaton se janë mënjeluar parregullsitë e përcaktuara nga paragrafi (1) i këtij neni, miraton konkluzion me të cilin e ndërpret procedurën e mbikëqyrjes inspektuese.

(8) Nëse inspektori shtetëror i arsimit gjatë kryerjes së mbikëqyrjes kontrolluese konstaton se nuk janë mënjeluar parregullsitë e përcaktuara nga paragrafi (1) i këtij neni, parashtron kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje në gjykatën kompetente.

(9) Inspektorati Shtetëror i Arsimit i cili e ka kryer mbikëqyrjen inspektuese mban evidencë për edukimin e realizuar në mënyrën e përcaktuar nga ministri.

VI. DISPOZITA PËR KUNDËRVAJTJE

Neni 19

(1) Gjobë në shumë prej 1.000 deri në 2.000 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm, nëse:

- zbaton statut për të cilin nuk ka marrë pëlqim nga Ministria (neni 4 paragrafi (4)),
- programin vjetor për punë nuk ia dorëzon themeluesit në afatin e caktuar (neni 9 alineja 3) dhe
- raportin vjetor për punë nuk ia dorëzon themeluesit në afatin e caktuar (neni 9 alineja 4).

(2) Gjobë në shumë prej 500 deri në 1.000 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje drejtorit të universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 2.000 deri në 3.000 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm, nëse:

- nuk mbahet apo mbahet dhe lëshohet dokumentacioni dhe evidenca pedagogjike në kundërshtim me nenin 5 të këtij ligji,
- nuk miraton vendim tre muaj para kalimit të mandatit të drejtorit ekzistues që të shpall konkurs publik për emërimin e drejtorit (neni 12 paragrafi (2)),
- nuk mundëson kryerje të mbikëqyrjes mbi ligjshmërinë dhe mbikëqyrjes inspektuese (neni 17).

(4) Gjobë në shumë prej 1.000 deri në 1.500 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje drejtorit të universitetit të hapur qytetar për mësim të përhershëm për veprimet nga paragrafi (3) i këtij neni.

(5) Gjobë në shumë prej 500 deri në 800 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje arsimtarit, nëse:

- nuk e mban dokumentacionin dhe evidencën pedagogjike ose e mban dhe e lëshon në kundërshtim me nenin 5 të këtij ligji dhe
- nuk mundëson kryerje të mbikëqyrjes mbi ligjshmërinë dhe mbikëqyrjes inspektuese (neni 17).

Neni 20

(1) Procedurë për kundërvajtje mban dhe sanksione për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente.

(2) Para parashtrimit të kërkesës për procedurë për kundërvajtje për kundërvajtjet e parapara në këtë ligj, Inspektorati Shtetëror i Arsimit udhëheq procedurë për barazim në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

VII. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 21

(1) Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji universitetet ekzistuese të punëtorëve dhe ato popullore vazhdojnë punën si universitete të hapura qytetare për mësim të përhershëm të komunave dhe të qytetit të Shkupit.

(2) Nëse komunat dhe qyteti i Shkupit me vendim nuk i marrin universitetet e hapura qytetare për mësim të përhershëm, universitetet ekzistuese të punëtorëve dhe ato popullore mund të transformohen në institucione private në pajtim me dispozitat për transformim të institucionit publik në institucion privat sipas Ligjit për institucione, duke pasur kujdes që gjatë përcaktimit të vlerës së objekteve dhe pronës së universiteteve ekzistuese të punëtorëve dhe atyre popullore, mjetet e investuara nga të punësuarit, të fituara nga vetëfinancimi, të llogariten si kapital i investuar, që do të merren parasysh gjatë vlerësimit.

Neni 22

Objektet dhe pronën e universiteteve ekzistuese të punëtorëve dhe atyre popullore, të cilat janë në pronësi të Republikës së Maqedonisë, me vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë i marrin komunat për universitetet e hapura qytetare për mësim të përhershëm në rajonet e tyre, me kusht që të vazhdojnë ta realizojnë veprimtarinë për të cilën janë themeluar.

Neni 23

Universitetet ekzistuese të punëtorëve dhe ato popullore në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji e harmonizojnë organizmin, punën, statutin e vet dhe aktet tjera me këtë ligj.

Neni 24

Drejtorët e universiteteve ekzistuese të punëtorëve dhe atyre popullore, e vazhdojnë punën si drejtorë të universiteteve të hapura qytetare për mësim të përhershëm deri në kalimin e mandatit për të cilin janë emëruar.

Neni 25

Aktet nënligjore të parapara në nenin 18 të këtij ligji do të miratohen në afat prej 15 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Neni 26

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".